



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE
AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
"26 MARS" KAVAJË

Nr. 19 prot.

Data 10/02/2023

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME
PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE
AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit të MFE nr.28 date 14.10.2019 "Per numrin e nxënësve per klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit profesional" (Fletore zyrtare 2020 - Nr 12), të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional si dhe aspektet e menaxhimit te burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve te AFP-së dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", neni 107, 108, 109, Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale "26 Marsi" Kavajë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

Mësues të formimit të kulturës profesionale për teori në drejtimin Mekanikë.

- 1 (një) mësues (MËSUES zëvendësues për leje barrë lindje)

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit e AFP-se, duhet të plotësojë këto kritere:

1. Kriteret e përgjithshme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme, në të njëjtën fushë me njërë nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;

- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

3. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara; Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda afateve të përcaktuara në aplikim 09.03.2023

Drejtore
Bledar Teferiçi

